

NË LULISHTEN E KUR'ANIT

VULLNET MERJA

E vërteta e Kur'anit

Allahu i Madhërrur në Kur'an thotë:

“O ithtarët e Librit! Juve ju erdhi i Dërguari Ynë, i cili ju shpjegon gjëra nga ato që i keni fshehur ju prej Librave (Teuratit dhe Ungjillit) dhe ju fal shumë. Juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kurani), “me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë.” (Sure “Maide”, ajetet 15-16)

Besoj se nuk gaboj po të them që Kur'anit është shpirt dhe trup. Shpirti i tij është i simbolizuar me udhëzimin dhe dritën kurse trupi i tij letrat dhe fjalët e shkruara në të. Të arriturit e trupit të Kur'anit është e lehtë për të gjithë, qofshin besimtarë apo jobesimtarë. Mirëpo, të arriturit e shpirtit të Kur'anit të dritës së tij e të udhëzimit të tij që Allahu i Urtë e i Plotfuqishëm ka vendosur në të është ndryshe nga të arriturit e trupit. Kjo sepse është e domosdoshme që njeriu të ketë shirt të pastër e të lartë që ta kuptojë Kur'anin. Shpirti i njeriut ka nevojë për ndriçim dhe mjet për zbulimin e të vërtetave. Allahu i Madhërrur e cilëson Librine Tij se shtë dritë dhe libër i qartë. Kjo dritë është e dobishme vetëm për atë që zotëron arsyetim dhe librin nuk e kupton vetëm se zotëruesi i mendjes. Nëse njeriu nuk zotëron vëmendshmërinë e as mendjen e shëndoshë, ai është i paaftë për të kuptuar Kur'anin dhe përmajtjen e tij të thellë e të pashterur. E vërteta e Kur'anit është se ai është libër. Libër do të thotë se diçka konstante e qëndrueshme. Në Kur'an çdo gjë është e qartë dhe konstante që sqarojnë të vërtetat dhe zbulojnë çështjet e jetës dhe rregullat e saj të përgjithshme. Allahu i Plotfuqishëm udhëzon nëpërmjet Kur'anit. Por kush është i aftë për këtë udhëzim? Në ajetin e lartpërmendur thuhet se të aftit për udhëzim janë: **“...ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë.”** Prej dëshirave më të mëdhaja të njeriut është që të jetojë jetë të qetë e të kënaqshme si dhe të sigurojë shpëtimin në Jetën Tjetër. Të gjitha këto arrihen duke studiuar Kur'anin dhe duke zbuluar të vërtetat e tij të pafundme të cilat po sqarohen dita ditës me përparimin e shkencës e të teknologjisë. Cilido që ndjek porosinë e Allahut, e meriton që Allahu ta nxjerrë prej errësirave në dritë. Këto errësira janë trupëzuara me moralet e këqija, padrejtësinë, mendjemadhësinë, fanatizmin verbues, paditurinë dhe shkatërrimin. Kurse drita është moralet e mira, udhëzimi, mëshira, dija, arsuetimi, etj. Të gjitha

këto na i sqaron Kur'anin dhe na urdhëron që të jemi gjithmonë me dritën dhe të largohemi prej errësirave humbëse e shkatërruese.

Si ta kuptojmë Kur'anin?

Allahu i Madhëruar në kur'an thotë:

“ Ne edhe para teje kemi dërguar vetëm njerëz, të cilëve u kemi dhënë shpallje, andaj pyetni dijetarët e Librit, nëse nuk e dini (këtë).

‘(Të dërguarit i çuam) me prova të qarta dhe libra. Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kuranin), me qëllim që t’u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë. (Sure “Nahl”, ajetet 43-44)

Cila është rruga e drejtë dhe e saktë për kuptimin e Kur'anit? Si ta kuptojmë Kur'anin?

Përgjigja: Studimi dhe praktimi janë garantues për zbulimin e të vërtetave që përmban Kur'anin. Kur'anin është bërë i lehtë për t’u kuptuar. Kjo do të thotë se Allahu i Madhëruar e ka sqaruar atë dhe e ka bërë të lehtë për tu kuptuar si për arabët ashtu edhe për joarabët. Nëse studiohen ashtu siç duhet ajetet e Kur'anit, atëherë nuk ka vend uni në brendinë e njeriut. Nuk lejohet që njeriu ta komentojë sipas mendimit të tij Kur'anin. Është transmetuar nga profeti Muhamed (as) i cili ka thënë: “Kushdo që e komenton Kur'anin me idenë e tij, ai ka shpifur gënjeshtër për Allahun.” (Biharul Anuar, vëll 36, f. 227)

Nëse përballesh me paqartësi në ndonjë tekst kur'anor, mos u nxito por pyet të diturit të cilët e kanë kuptuar Kur'anin dhe që Allahu i ka bërë të veçantë për këtë çështje. Allahu i Madhëruar thotë:

“Në xhamitë, që Allahu ka urdhëruar të ngrihen e të përmendet aty emri i Tij, Atë e lavdërojnë në mëngjes dhe mbrëmje.”

“Njerëz, të cilët shitblerja nuk i pengon për të përmendur Allahut dhe të cilët falin namazin dhe japin zeqatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara.” (Sure “Nur”, ajetet 36-37)

Ata janë Profeti Muhamed dhe familja e tij (Ehlu Bejti) (paqja qftë mbi ta!). Kushdo që ecën në rrugën e tyre, e kupton Kur'anin, nuk është prej pasuesve të epshit dhe as nuk e pengon as tregëtia e as zbavitja nga njohja e Allahut të kujtuarit e Allahut, e as nga zbatimi i urdhrave të Tij, do të jetojë jetë të lumtur në këtë jetë (nuhjihi hajaten tajjibeh) dhe do të jetë prej të shpëtuarve në Ditën e Gjykimit.

Përse nuk e përsiatin Kuranin?

“Vallë, a nuk përsiatin ata për Kuranin apo i kanë zemrat të kyçura?! (Sure “Muhamed”, ajeti 24)

Allahu i madhëruar krijoi dritën dhe e ndau në dy pjesë: të parën e vendosi tek njeriu dhe e quajti mendje, intelekt. Me pjesën e dytë krijoi një libër që e quajti Kur'an fisnik. Kur'ani është libri që Allahu e ka programuar me gjuhën e njeriut dhe e zbriti nga lart që ta kuptojë krijesa e nderuar, njeriu. Pa dyshim që gjendet përputhshmëri mes mendjes dhe Kur'anit e cila e çon njeriun tek e vërteta. Prandaj mund të themi me plot bindje se Kur'ani është mendja e jashtme dhe mendja është Kur'ani i brendshëm. Sa më shumë të ndriçohet mendja me ajetet e Kur'anit dhe sa më shumë të zbatohet kur'ani aq më shumë kuptohet Kur'ani. Kur'ani nuk mund të kuptohet pa një mendje të shëndoshë gjithashtu as mendja nuk mund të jetë e shëndoshë pa Kur'anin. Ura lidhëse mes Kur'anit dhe mendjes është studimi, logjikimi dhe arsyetimi në ajetet e tij. Lexuesi i Kur'anit nuk duhet ta lexojë kalimthi ose leximi të jetë thjesht lëvizje e gjuhës por duhet të mendojë thellë për të arritur në xhevahirin e shenjtë dhe në dritën që ka vendosur Allahu në fjalët e Tij. Përsa i përket shakqeve të mosmendimit dhe arsyetimit gjatë leximit të Kur'anit themi se djalli i mallkuar përpiket që njeriu gjatë leximit të Kur'anit të mendojë për çdo gjë por të mos mendojë për përmbajtjen e atij që po lexon!!! Ashtu siç pëshpërit në zemër gjatë namazit, agjërimit e adhurimeve të tjera po ashtu vepron edhe gjatë leximit të Kur'anit. Për këtë Allahu na urdhëron që para se të fillojmë leximin e Kur'anit të themi "eudhu bil'lahi mine shejtani rraxhijm". Një shkak tjetër është kyçja e zemrës me mendime devijuese të cilat e pengojnë lexuesi që të përfitojë prej Kur'anit.

Kur'ani është libër për të gjithë

Elif Lám Râ. Ky është një Libër, vargjet e të cilit janë radhitur mrekullueshëm dhe janë parashtruar me hollësi nga ana e Një të Urti të Gjithëdijshëm. (Sure "Hud", ajeti 1)

Edhe pse me kalimin e kohëve njeriu ka përparuar, qoftë në teknologji apo në kuptim, Allahu e ka zbritur Kur'anin për të gjithë njerëzit dhe për të gjitha kohët. Kjo e vërtetë e pasdikueshme konsiderohet prej mrekullive të mëdhaja të Kur'anit, Librit epokbërës. Sepse prej vetive dhe karakteristikave të Kur'anit është se ai u flet të gjithë njerëzve, pa dallim, mentaliteti, ideologjie, kombi, race, ngjyre, gjuhe, vendi e kohe. Kjo për faktin se Kur'ani përmban të brendshëm dhe të jashtëm dhe e brendshmja e tij është shumë e thellë. Sa më shumë të zhytëmi në thellësitë e Kur'anit aq më shumë do të paisemi me dije e me njohje. Në një kohë që njeriu i thjeshtë kupton nga kur'ani diçka të caktuar, shohim që dietari, hulumtuesi studiuesi e mendimtari e kuptojnë më shumë dhe janë të aftë të nxjerrin ligje e rregulla për njerëzit. Të tillë kanë qenë profeti, mësuesi dhe

komentuesi i parë i Kur'anit dhe imamët prej familjes së tij të pastër. Në çdo kohë, njerëzit kanë përfituar shumë prej Kur'anit njësoj si shiu që zbrit prej qiellit që shpërndahet në tokë e në luginë ku secila tokë e luginë depoziton aq ujë sa i nevojitet. Përderia Kur'ani është libër me vlera të larta dhe burim i pashtershëm dijesh për mbarë njerëzit dhe kohët, është detyrë që këto dije e njohje të përhapen akoma më shumë dhe me mjete të ndryshme. Kur'ani është libri i të gjithëve. i zbritur nga Allahu, Krijuesi i gjithçkaje. Nëse dikush nuk e kupton tekstin e Kur'anit, është detyrë që të pyesë të diturit prej dijetarëve dhe specialistëve të fushës së Kur'anit. Duhet që nga Kur'ani të përfitojnë të gjithë njerëzit, sipas mundësive dhe aftësive që kanë. Nuk duhet që Kur'ani të jetë i posaçëm për një grup njerëzish apo dijetarësh.

Kur'ani në hadithe

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: **“Përparësia e Kur'anit mbi fjalët e tjera është si mirësia e Allahut mbi krijesat e Tij.”** (Biharul Anuar, vëll. 89, f.19)

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: **“Allahu nuk e dënon atë zemër që e ka kuptuar Kur'anin.”** (Tefsirul Burhan, vëll. 1, f. 7)

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: **“Kush kërkon dijen e të parëve dhe dijen e të fundmëve, të lexojë (studiojë) Kur'anin.”** (Biharul Anuar, vëll. 89, f.19)

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: **“Më i miri ndër ju është ai që e mëson Kur'anin dhe ua mëson atë të tjerëve.”** (Biharul Anuar, vëll. 89, f.19)

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: **“Nëse dëshironi jetën e të lumturve, vdekjen e martirëve, shpëtim në ditën e vështirë, hijëzim në ditën e nxehtë dhe udhëzim në ditën e humbjes, mësojeni Kur'anin sepse ai është fjala e Gjithmëshirmit (Rahmanit), mbrojtje prej shejtanit dhe anues kah të mirat në ditën e llogarisë.”** (Mijzanul Hikmeti, vëll. 8, f. 74.)

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: **“Vërtet, ai që mëson Kur'anin dhe ua mëson të tjerëve si dhe zbaton ato që përmban, unë do të jem tdrejtuesi i tij për në xhennet dhe do të jem treguesi i tij për në xhennet.”** (Mijzanul Hikmeti, vëll. 8, f. 75.)

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: **“Cilido prind që ia mëson fëmijës së vet Kur'anin, Allahu do t'i**

veshë atyre kurorën e mbretit ndhe do t'i me rroba që njerëzit nuk i kanë parë asnjëherë" (Meusuatul Fikh, vëll. 98, f. 187.)

imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: **"Për Allah, për Allah, Kur'anin. Askush të mos jetë më parësor se ju në zbatimin e tij."** (Nehxhul Belaga, shkresa 47.)

Imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: **"Përmendja më e mirë është Kur'ani. Me të tushrah gjokset dhe ndriçohen të fshehtat."** (Mizajnul Hikmeti, vëll. 8, f. 67)

imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: **"Mësojeni Kur'anin sepse ai është biseda më e mirë. Mendoni në të sepse ai është pranvera e zemrave. Kërkoni shërim prej dritës së tij sepse ai është shërues i gjokseve. Lexojeni sa më bukur sepse ai është rrëfimi më i përkryer. (Nehxhul Belaga, fjalimi 110)**

Prijësi i besimtarëve, imam Aliu (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: **"Pjalmimi i besimit është leximi i Kur'anit."** (Mizjanul Hikmeti, vëll. 8, f. 81.)

imam Hasan ibn Ali (paqja qoftë mbi të dy!) ka thënë: **"Cilido që lexon Kur'anin atij do t'i pranohet lutja, herët apo vonë."** (Biharul Anuar, vëll. 98, f. 204)

Imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: **"Besimtari nuk duhet ta arrijë vdekja pa e mësuar Kur'anin ose të jetë duke e mësuar atë."** (Meusuatul Fikh, vëll. 98, f. 186.)

imam Sadiku (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: **"Tri gjëra ankohen tek Allahu i Madhëruar; xhamia e prishur xhemati i së cilës nuk e frekuenton atë, dijetari në mesin e të paditurve dhe Kur'ani i varur të cilin kanë zënë pluhurat."** (Meusuatul Fikh, vëll. 98, f. 212.)

Që nga koha e krijimit të babait tonë, hazreti Adem (paqja qoftë mbi të!) e deri në fund të kësaj jete, njeriu kurrë nuk ka lexuar e nuk do të lexojë libër më të lartë e më të begatë se Kur'ani fisnik. Ai ka qenë është dhe do të jetë më i larti i librave. Ai është Libri i Allahut dhe vula e mesazheve qiellorë. Ai është sqarues i gjithçaje dhe nuk është i veçantë për një grup të caktuar njerëzish por është Libri i të gjithë njerëzve dhe i lehtë për t'u kuptuar.

Prej madhësisë së Kur'anit është se ai nuk ka qenë e as nuk do të jetë libër i një dijeje të veçantë apo i disa temave të caktuara por, ai është libër i njeriut i shoqërisë dhe i qytetërimit. Është libër i legjislacionit qiellor dhe i udhëzimit. Në të flitet për moralin, besimin ekonominë, politikën shoqërinë, dijen etj. Nuk ekzagjeroj kur them se kur'ani është Libri i jetës. Ajetet e tij të qarta nuk e kufizojnë kuptimi i fjalëve e as mendjet e gjenive. Ato janë si dielli i cili çdo ditë që lind ai e vesh gjithësinë me një petkt të ri me rrezet e tij të arta. Sa herë që lexohet Kur'ani gjendet kuptim i ri dhe zbulohen horizonte që nuk mendoheshin apo të përfytyroheshin.

Ai gjithmonë është libër i gjallë dhe kurrë nuk shterron sepse është i ardhur nga i Plotfuqishmi dhe i Përjetshmi që nuk e kaplon as dremitja e as gjumi.

Duke qenë i tillë, është detyrë e jona që ta studiojmë dhe ta kuptojmë Kur'anin. Ta zbatojmë në realitetin tonë dhe ta bëjmë prijësin tonë në çdo fushë të jetës. Të përfitojmë sa më shumë prej tij me qëllim që të ndërtojmë një personalitet të fortë dhe të zbatojmë këshillat dhe porositë e tij. Duhet që mos dalim nga kjo rrugë sepse ajo është e vetmja rrugë që na siguron jetë të këndshme e të lumtur në këtë jetë dhe në jetën tjetër.

Ne dhe Kur'ani

Allahu i Madhëruar në Kur'an thotë:

27. Atë Ditë keqbërësi do të hajë gishtat e duarve të veta, duke thënë: "Ah, sikur ta kisha marrë rrugën (e drejtë) me të Dërguarin!

28. Ah, sikur të mos e kisha bërë filanin mik!

29. Ai më ka larguar nga Këshilla (Kurani) që më kishte ardhur!" Në të vërtetë, djalli e braktis gjithmonë njeriun në çastin e nevojës.

30. Dhe i Dërguari do të thotë: "O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kuranin, si (diçka) të urryer".

31. Dhe, kështu Ne, çdo profeti i kemi kundërvënë një armik nga keqbërësit. Por ty të mjafton Zoti yt si udhërrëfyes dhe ndihmës!

32. Jobsimtarët thonë: "Përse Kurani nuk i është shpallur i tëri përnjëherë?!" Ne ta kemi shpallur kështu për të forcuar zemrën tënde dhe ta kemi zbuluar qartazi varg pas vargu. (Sure "Furkan", ajetet 27-32)

Në kohën e globalizmit, në të cilën po afrohen largësitë dhe po hiqen kufijtë; bota po shndërrohet e ngjashme me një fshat të vogël dhe ka përparuar dija e teknologjia, vallë a kemi nevojë për Kur'anin? nëse po, përse? Çfarë pozite ka te ne Kur'ani? A thau se po të kapemi pas Kur'anit na la treni i integritit dhe kemi dalë jashtë shinave të kohës?!

Përgjigjet e të gjitha këtyre pyetjeve e kanë burimin tek e vërteta e pikëpamjes së njeriut për njeriun. Sepse po ta njohim ashtu siç duhet këtë krijesë, e kemi shumë të lehtë zgjidhjen e shumë problemeve të pazgjidhura. Ç'është njeriu? A është shefat, frikë, dyshim apo është më larg se këto? Para çdo gjëje pyesim se kujt i takon në fillim të bëjë njohjen e njeriut? Sigurisht që Krijuesi i tij sepse Ai është më i dituri për ato që ka krijuar. Ai ka thënë se e ka krijuar njeriun në formën më të përkryer dhe e ka nderuar dhe lartësuar mbi të gjitha krijesat e tjera. Prandaj, këtë krijesë duhat ta shohim me shikim të mbushur me nderim e respekt sepse është krijesa e Allahut të Madhëruar.

Njeriu është shumë më i lartë sepse Allahu i fry shpirtin dhe i bëri engjut t'i përulen atij në shenjë nderimi. Në kohët e sotme në të cilën janë përhapur pasuria

dhe lakmia, njerëzit me pozita mundohen t'i shfrytëzojnë njerëzit në maksimum për hir të interesave të veta. Në këto ditë të tilla njeriu ka nevojë më shumë se kurrë për vlera, shpirt dhe frymë të shenjtë. Në këtë botë të teknologjisë, pasurisë, atomit e raketave, kemi nevojë për njerëz që i mbështeten Allahut dhe kapen pas litarit të Tij, fesë së drejtë islamit dhe që ngrenë zërin kundër keqbërësve e të padrejtëve duke thënë se Zoti është një e i Vetëm. Atij i takon përlulja dhe adhurimi.

Këtë nevojë mund ta sigurojmë nëpërmjet realizimit të disa projekteve si:

Së pari: Ndërtimi i qendrave studimore logjike për brezat e ardhshëm bazuar tek Kur'ani me qëllim që të kemi një të ardhme të ndritur me dritën e Kur'anit që nuk i vjen e kota nga asnjë anë dhe ai është sqarues për çdo gjë ky projekt të fillojë tek filizat e shoqërisë. T'i mësojmë aty ajetet e Kur'anit dhe t'ua sqarojmë me mënyrë të thjeshtë, tërheqëse dhe të përshtatshme pa dyshim që kjo kërkon ngritjen e qendrave të posaçme për studimin e Kur'anit dhe qëllimi i këtyre qendrave të jetë që mendjet e fëniëve myslimanë të ndriçohen që në vegjëli me fjalën e Krijuesit, Allahut të Madhëruar.

Së dyti: Kur'ani dhe dijet e tij të pashtershme të jetë epiqendra e punëve dhe e lëvizjeve tona në këtë jetë të mbushur me sfida e me mentalitete të ndryshme materiale.

Së treti: Kur'ani të jetë boshti i studimeve tona. Të mos shpenzojmë kohën me çështjet e ndryshme filozofike dhe me diskutimet e debatet pa vlera e padobi. Por t'i kthehemi Kur'anit e ta studiojmë ashtu siç e meriton dhe jo thjesht ta marrim Kur'anin argumentues të disa mendimeve apo ideve personale të cilat mund të jenë në kundërshtim me fjalën e Allahut të Madhëruar. Këtë e them se filozofia është e paaftë të gjallërojë jetën e njeriut. E kundërta ndodh me Kur'anin i cili është i mbushur me këshilla e urtësi për të cilat kanë nevojë të gjitha grupmoshat dhe shtresat e shoqërisë. Është detyrë e çdo muslimani dhe muslimaneje që besimi i tyre dhe punët e tyre ta kenë burimin tek Kur'ani fisnik dhe të mos e lënë pas dore atë siç po ndodh në këto kohë ku njerëzit e kujtojnë praninë e Kur'anit për leximin e Jasinit apo për hapje programesh të ndryshme. Thënë ndryshe, padituria e shkuar dhe ajo moderne, kanë sunduar mendjet e mjaft muslimanëve e kjo si pasojë e moszbatimit të Kur'anit që është dritë udhëzimi për mbarë njerëzimin. Mirëpo mosinteresimi ndaj tij, ka bërë që njerëzit të mbeten në udhëkryqin e teknologjisë së shpejtë dhe nuk dihet se ku do t'i përplasë!!!

Kur'ani, libër i veprave

Kur njeriu blen ndonjë paisje të re, puna e parë që do të bëjë do të kërkojë të shohë katalogun sqarues të asaj paisjeje se si funksionon dhe si duhet ruajtur.

Allahu i Madhëruar kur e krijoi ekzistencën dhe jetën, Ai dërgoi për njerëzit libra dhe u mësoi atyre mënyrën e jetesës në këtë jetë. U sqaroi atyre ligjet dhe rregullat e qetësisë dhe paqes në jetë. Këtë libër e ka quajtur Kur'an. Pra, Kur'ani është Libri i Allahut i shkruajtur e i lexuar. Gjithashtu edhe gjithësia është libër i Allahut. Të dy këto libra janë në përshtatje dhe në përputhje të lotë me njëri tjetrin. Ai që do të njohë jetën dhe natyrën, të lexojë Kur'anin dhe të ndriçohet me dritën e tij të pashuar. Ata të cilët e lexojnë kur'anin pas portave të mbyllura pa vështruar se çfarë gjendet rreth tyre, ata nuk mund të përfitojnë prej këtij Kur'ani. Gjithashtu, ata të cilët dëshirojnë të njihen me jetën dhe me natyrën pa patur ndonjë libër udhëzues e sqarues, asnjëherë nuk mund ta kuptojnë. Jeta njihet me leximin saj me praktimin e saj dhe me të jetuarit e saj sipas Librit të Allahut që sqaron gjithçka. Nëse njeriu dëshiron të jetojë jetë të ndritur, të ndriçohet me Kur'anin, të lexojë përmbajtjen e tij e cila sqaron natyrën e njeriut, të shoqërisë dhe zhvillimin e jetës. Në të ka përgjigje të qarta rreth krijimit të univesrit dhe qëllimit të tij. Ka përgjigje për shkaqet e përparimit të popujve të shkuar dhe për shkaqet e shkatërrimit të tyre...etj. Të gjitha këto, njeriu i gjen vetëm tek Kur'ani fisnik. Prandaj është detyrë e njeriut që ta zbatojë Kur'anin në jetën e tij të përditshme. Asnjëherë të mos mungojë Kur'ani në jetën tonë. Të jetë njësoj si dielli që lind përditë. Sepse ai nuk ka zbritur për një popull të caktuar por Allahu e ka zbritur për mbarë njerëzinë. Ai ecën siç ecën nata dhe dita. Ta lexojmë Kur'ani dhe ta zbatojmë tek vetat tona, tek të tjerët, tek zgjidhja e problemeve dhe e situatave të vështira, siç janë ato psikologjike me qëllim që ta njohim më mirë Kur'ani dhe të njihemi më mirë edhe me jetën që jetojmë. Leximi i Kur'ani pa u praktikuar apo të jetuarit pa Kur'an, nuk është tjetër veçse moszbatim i Kur'anit dhe humbje e jetës. Ne Kur'an lexojmë se profeti do të ankohet tek Alahu për moszbatimin e Kur'anit: **30. Dhe Dërguari do të thotë: "O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kuranin, si të urreyer". (Sure "Furkan", ajeti 30.)**

Kur'ani, Libër i urtësisë

Në fletët e Kur'anit lexojmë se ai është libër i urtësisë, për këtë është quajtur edhe 'el Kur'anul hakim', Kur'ani është i urtë, sepse përmban urtësinë e jetës. Ai njeri që dëshiron të fitojë lumturinë në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër, duhet patjetër të mbartë urtësinë. Që do të thotë se duhet të njohë mënyrën e të jetëuarit; të dijë se nga ka ardhur, pse ka ardhur, ku do të shkojë; të dijë se cilat janë ligjet e jetës që ka vendosur Krijuesi për këtë jetë që të jetojë jetë të kënaqshme. Të gjitha këto ligje, të cilat janë të vërteta të mëdhaja që nuk është e lehtë për njeriun që t'i kuptojë sepse mendja e tij është e kufizuar, i sqaron Kur'ani i urtë.

Dihet se të gjithë njerëzit nuk janë të barabartë. Ata ndryshojnë dhe kanë nivele të ndryshme. Është e habitshme që me gjithë këtë ndryshueshmëri të njerëzve nga ana mendore e logjke, ata përfitojnë të gjithë nga Kur'anin sipas niveleve të tyre. Këtë e shohim më qartë kur lexojmë se njerëzit më të lartë, profeti Muhamed, familja e tij e pastër dhe shokët e tij të zgjedhur, e lexonin Kur'anin dhe përfitonin prej tij. Po ashtu edhe njeriu ,ë i thjeshtë e lexon dhe përfiton prej tij. Sekretet qëndron në shembujt dhe tregimet e shumta që përmenden në Kur'an të cilat janë urë lidhëse mes njeriut dhe të vërtetave. Prandaj, cilido që lexon Kur'anin të mendojë në ajetet e tij dhe t'i zbatojë ato. Duhet të dimë se shembujt sqarojnë të vërtetat. Nëpërmjet kuptimit të shembujve që përmenden në Kur'an dhe zbulimit të të vërtetave që kanë lidhje me ato shembuj, njeriu mund të bëhet i urtë. Allahu i Madhëruar në Kur'an thotë: **“Ai ia jep urtësinë (të kuptuarit e Kuranit) kujt të dojë. Cilido që i është dhënë urtësia, vërtet që i është dhënë një mirësi e madhe. Por këtë nuk e kupton tjetërkush, përveç njerëzve të mençur.”** (Sure “Bekare”, ajeti 269)

Kur'anin, Libri i udhëzimit

(Thuaju o Muhamed): **“Tashmë ju kanë ardhur nga Zoti juaj prova të qarta. Ai që i sheh ato, i sjell dobi vetes, ndërsa ai që i mbyll sytë para tyre, i bën dëm vetes. Unë nuk jam rojtari juaj.”** (Sure “En'am”, ajeti 104)

I biri i Ademit e fillon jetën e tij pa asnjë sprovë dhe jeton në të errësirat e paditurisë e të pavëmendshmërisë. Moshë është e shkurtër dhe të padukshmet e jetës janë më të shumta se të dukshmet. Ajo është si përzierje e ndërlikuar bazuar mbi baza për të cilat njeriu nuk ka shumë njohuri për atë. Kështu që i biri i Ademit ka nevojë për udhëzues që ta udhëzojë në ligjet e jetës në natyrën e saj dhe në sistemin e saj dhe në krijesat rreth tij. Gjithashtu ka nevojë për një njeri që ta mësojë se si të bashkëpunojë me veten dhe me të tjerët. Kur'anin është udhëzuesi, mësuesi drita dhe ndriçuesi, rruga e të menduarit të shëndoshë. Ai është njohja dhe e vërteta. Është e vërtetë se njerëzit pa konsultën me mendjet e tyre, pa ndriçimin e mendjeve të tyre, pa zbatimin e premtimit të tyre dhe pa vënien në funksion të paisjes së njohjes në veta e tyre, janë të paaftë që të përfitojnë prej Kur'anit. Gjithashtu, është e vërtetë se pa Kur'anin, pa udhëzimin e tij, pa dijen e tij dhe pa pastrimin e tij, ata janë të paaftë të udhëzohen. Kur'anin fisnik thotë: “

فَدَّ جَاءَكُمْ
بَصَائِرُ مِنْ رَبِّكُمْ

Kur'anin, rruga e zhvillimit dhe e qytetërimit

143. Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari të jetë dëshmitar përmbi ju. Ne nuk e kemi bërë kthimin tënd nga Qabeja (o Muhamed) për tjetër arsye, por vetëm për t'i dalluar ata që i shkojnë pas të Dërguarit, nga ata që kthehen nga thembrat (që tërhiqen nga besimi tek ai). Kjo provë ka qenë e rëndë (për njerëzit), por jo për ata që Allahu i ka udhëzuar. Dijeni se Allahu nuk ua humb besimin tuaj (d.m.th. namazin që keni falur nga Kudsi). Në të vërtetë, Allahu është Përdëllimtar dhe i Mëshirshëm me njerëzit. (Sure "Bekare", ajeti 143)

Mesazhi islam bashkoi popuj dhe krijoi qytetërimin më të fortë në këtë botë. Sepse arabët para islamit jetonin të shpërndarë në Gadishullin arabik. Përgjatë 23 vjetëve, Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) i bëri bashkësi që të jenë dëshmitarë përmbi njerëzit me dejtësi e vërtetësi. Kur'an shpërthen tek njeriu fuqitë e tij dhe e bashkon njerëzinë në një bashkësi të vetme. Kjo sepse kur'an është libër i përjeshëm dei në ditën e kiametit. Krijuesi i njeriut, Allahu i madhëruar i ka premtuar njeriut shpërblim por edhe e paralajmëron për dënimin. Kjo do të thotë se Ai nuk e ka krijuar njeriun vetëm për këtë jetë dhe të zhduket me vdekjen sepse kjo jetë nuk është veçse mjet prej mjeteve të zhvillimit të njeriut në skajet më të larta. Në kohën që Kur'an zgjeron horizontet e njeriut, ai forcon shpirtin e vendosmërisë e të vullnetit të fortë dhe fton në njohjen e vetvetes e në përpjekje të vazhdueshme gjatë gjithë jetës me qëllim që njeriu të triumfojë mbi fuqitë e unit e të prangosjes së djallit. Besimtari i vërtetë e di se koja e jetës së tij është e kufizuar prandaj përpiqet që këtëkohë ta shfrytëzojë sa më mirë për të arritur në majat e urtësisë e të zhvillit si dhe për të fituar kënaqësinë e krijuesit të tij në këtë jetë dhe në Jetën Tjetër. Ata e pasojnë Kur'anin dhe e zbatojnë atë. Nuk ua lejojnë vetes që jeta e tyre të jetë viktimë e djallit dhe e veprimeve djallëzore. Duke qenë të tillë ata janë më të nderuarit e kësaj jete dhe ahiretit. Kur'an është ai që e ruan njeriun dhe e drejton atë në rrugën e mirësisë e të shpëtimit. Zbatimi i Kur'anit është kusht i të qenit bashkësia më e mirë në mesin e njerëzve dhe të jetë dëshmitare përmbi ta.

Kur'an i udhëzon në atë që është më e mira:

Në suren "Isra", ajeti 9, Allahu i Madhëruar thotë: **"Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh."**

Kush jeton në errësirë, ëndërron për dritën. Kush jeton në humnerë nuk i njeh majat. Kjo jetë që ne jetojmë, e mbushur me errësira, lëndime e fatkeqësi, nuk është jeta e vërtetë, sepse jeta që dëshiron Allahu të jetojmë është më e këndëshme dhe

më e lartë. Vërtet, Allahu na ka lajmëruar për jetën e begatë e të përsosur, jetën e mbushur me mirësi, mëshirë e begati. Vallë, ku është kjo jetë? Cila është ndarësja që na largon prej saj? Si ta heqim atë pengesë e ta zhdukim atë? Duhet të dimë se Allahu i Plotfuqishëm i ka krijuar njerëzit që t'i mëshirojë ata dhe që të jetojnë të lumtur në këtë jetë dhe të fitojnë kënaqësitë e Jetës Tjetër. Sigurisht, shkatërrimi, devijimi dhe degjenerimi që shohim mbi tokë dhe kanë mbuluar shumicën e saj, nuk janë prej Allahut sepse Ai ka thënë për Vetën e Vet: **“Zoti yt nuk është i padrejtë ndaj robëve.”** (Sure “Fusilet”, ajeti 46.)

Gjithashtu, ka thënë: **“41. Shkatërrimi në tokë dhe në det është shfaqur si pasojë e punëve të këqija të njerëzve...”** (Sure “Rrum”, ajeti 41.)

Të gjitha fenomenet e këqija e shkatërruese që janë përhapur në çdo skaj të rruzullit tokësor dhe kanë përfshirë të gjitha dimensionet e jetës tonë, janë përshkak të devijimit tonë nga rruga e drejtë dhe e vërtetë e cila është rruga e Allahut të Madhëruar. Që të kthehemi në rrugën e Allahut duhet të kthehemi te Kur’ani udhërrëfyes i cili është litari lidhës mes qiellit dhe tokës, është mjete i vetëm mes Krijuesit të qiejve dhe tokës, Zotit të botëve dhe mes njerëzve. Burimi themelor i problemeve tona në këtë kohë janë: devijimi mendor e ideologjik dhe devijimi moral. Allahu i Madhëruar e zbriti Kur’anin për shërimin e këtyre dy devijimeve të rrezikshme.

Devijimin mendor Kur’ani e shëron me dritën, udhëzimin dhe urtësinë e tij sepse ai është ndarësi i vetëm mes të drejtës dhe të padrejtës, të vërtetës dhe të pavërtetës. Sot përballemi me sulme të ashpëra kulturash të ndryshme të përfaqësuara nga idetë materiale dhe lakmuese që na paraqitet me anë të mjeteve të informacionit të cilat përpiqen që të shkulin rrënjët e besimit prej zemrave të besimtarëve nëpërmjet metodave e fasadave djallëzore. Këto ide materialiste dhe ky informacion helmues që dëgjojmë çdo ditë, e impresionijnë mendimin tonë dhe nuk na lënë të mendojmë për të ardhmen. Kjo sepse ato ide devijuese na serviren me metoda të përkryera djallëzore dhe përcillen nëpërmjet teknologjisë moderne. Me anë studimit e të kuptimit të Kur’anit arrijmë ta njohim më mirë jetën dhe ndryshimet e saj. Nëpërmjet Kur’anit, Allahu na sqaron të mirën dhe të keqen në këtë jetë. Çdo ditë dëgjojmë edicione lajmesh apo shohim programe televizioni apo vështrojmë faqet e internetit apo lexojmë libër e shfletojmë gazeta me qëllim që të mësojmë më shumë e të udhëzohemi. Mirëpo ajo që na udhëzon është mendja e shëndoshë e ndriçuar me dritën e Kur’anit dhe me udhëzimet e tij. Kjo mendje e shëndoshë na njeh me drejtësinë dhe të vërtetën dhe na e përbuz padrejtësinë dhe gënjeshtren.

Përsa i përket devijimit moral, i cili është i përhapur dhe ka mbuluar marë shoqëritë e sotme, edhe ky duhet shëruar duke u kthyer tek mësimet e Kur’anit i cili na mëson se si të jetojmë në këtë jetë kalimtare. Padyshim, që brezat e sotëm në përgjithësi, dhe ata muslimane në veçanti, po përballen me plane të shumta e

ndryshme djallëzore të cilat përhapen dita ditës nëpërmjet mjeteve të informacionit si televizionet, radiot, interneti, etj. Gjithashtu, po përballen edhe me fenomene të ndyta e shkatërruese siç janë prostitucioni, droga, alkoli, duhani, ...etj. Të gjitha këto fenomene çojnë në devijim moral, në shkatërrimin e individit, familjes dhe shoqërisë. Kemi plotësisht të drejtë të pyesim: Cili është mëkati i njeriut që e kanë mbërthyer kthetrat e këtyre mjeteve të informacionit, ku qëllimet e shumta të tyre janë djallëzore e shkatërruese? A nuk duhet t'i mbrojmë brezat e sotëm e të ardhshëm prej rënies në humnerat e devijimit moral? Patjetër. Kjo duhet bazohet duke u kthyer tek Kur'ani dhe ai të jetë udhërrëfyeni i gjithçkaje në jetën tonë. Ai është i vetmi që siguron paqen dhe sigurinë. Ai është i kapur me Kur'anin nuk bie pre e propagandës dhe e mashtrimeve shkatërruese. Pastaj, në anë të Kur'anit ndodhet edhe anija e shpëtimit që janë Ehli bejti i profetit Muhamed. Ata dhe Kur'ani janë të pandarë, siç thotë profeti Muhamed në hadithin e njohur: *"Unë kam lënë tek ju dy gjëra të çmuara nëse kapeni pas tyre nuk do të humbisni kurrë pas meje. Ato janë: Libri i Allahut dhe gjeneza ime, Ehli Bejti im. Ato kurrë nuk ndahen nga njëri tjetri derisa të vijë tek unë në burimin e Keutherit."*

Kur'ani, Libri i shpëtimit

"Allahu i Madhëruar thotë: "Sikur ta kishim shpallur Kuranin në një gjuhë tjetër, ata do të thoshin: "Ah, sikur vargjet e tij të ishin të kuptueshme! Vallë, pse të jetë në një gjuhë të huaj, ndërkohë që ai është arab?!" Thuaj: "Ai është udhërrëfyeni dhe shërim për besimtarët". Por ata që nuk besojnë, janë të shurdhër dhe të verbër, njësoj si të thirreshin prej vendeve të largëta." (Sure "Fusilet", ajeti 44.)

Gjatë jetës së tij, njeriu habitet prej problemeve dhe vështirësive papritura. Ka mundësi që të goditet nga kriza të shumta përshkak të disa problemeve që nuk di si t'i zgjidhë. Për këtë ai ka shumë nevojë për largpamësi që ta shpëtojë veten e vet apo dikënd tjetër duke e çuar në rrugën e shpëtimit. Por, nga vjen kjo largpamësi shpresëdhënëse? Kjo vjen nga Libri i Krijuesit, Mëshiruesit, të Dashurit e Dhuruesit. Lind pyetje: Si vjen kjo largpamësi? Shumica e njerëzve e dinë për praninë e udhëzimit, dritës dhe basairit në Kur'anin e urtë. Gjithashtu, duhet ta dinë se rrugëzgjdhja e problemeve të tyre ndodhet tek Kur'ani. Vallë, përse njerëzit nuk përfitojnë prej Kur'anit për problemet e tyre?

Përgjigje: Kjo sepse ata nuk e lexojnë Kur'anin dhe as nuk e studiojnë atë. Po të lexohet Kur'ani, padyshim që para njerëzve do të vizatohen të gjitha rrugëzgjdhjet e problemeve. Leximi i shpeshtë i Kur'anit dhe memorizimi i ajeteve të tij konsiderohen prej programeve të rëndësishme të jetës së njeriut, veçanërisht për brezin e ri.

Unë porosis të gjithë nënat dhe baballarët që t'ua mësojnë fëmijëve ajetet e Kur'anit. Kurse të mëdhenjtë ta lexojnë sa më shumë atë (Kur'anin) në çdo kohë të lirë, veçanërisht në mëngjes sepse ai do të jetë dëshmitarë në ditën kur do të dalim para Allahut të Madhëruar pa llogaritur mirësitë që do të gëzojnë në këtë jetë.